



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 355/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Blerta Peci, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës KDI, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, me objekt të çështjes, mbajtja e tubimit publik gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 14.02.2021, pa autorizim nga Komisioni Komunal Zgjedhor (KKZ), në Prizren, në seancën e panelit, të mbajtur me datë 11.02.2021, mori këtë::

V E N D I M

Hidhet e palejuar ankesa A.nr 355/2021 e datës 08.02.2021, e paraqitur nga Instituti Demokratik të Kosovës KDI, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Me datë 08.02.2021, Instituti Demokratik të Kosovës KDI, me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë në PZAP, me të cilën pretendon se gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme në vend ka vërejtur një parregullsi ashtu që me datë 07.02.2021, në Fshatin Lugishtë të Regjionit të Hasit në komunën e Prizrenit është mbajtur një tubim publik me diskutim dhe shpalosje të programit me qytetar nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, i cili tubim nuk ka qenë i paralajmëruar në KKZ, përkatësisht tek Zyrtari i Lartë Komunal i Zgjedhjeve. Me këtë paraqitësi i ankesës ka pretenduar se ky veprim i subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës është në kundërshtim me Rregullat Zgjedhore 13/2013, respektivisht nenin 7 par.1 dhe nenin 2 par.2 në lidhje me nenin 4 par.2 të kësaj rregulloreje.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj lejueshmërinë ankesën gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Me dispozitën ligjore të nenit 7 paragrafi 2 i Rregullës Zgjedhore Nr. 13/2013, përcaktohet se: “Nëse ZLKKZ-ja, ose Zyrtaret e Policisë së Kosovës hasin në tubim publik të paautorizuar, ata duhet të informojnë PZAP për hollësitë e tubimit publik:

për kohën, vendin, numrin e pjesëmarrësve në atë tubim publik, për subjektin politik që e mban tubimin publik, si dhe çdo informatë tjetër relevante lidhur me atë tubim publik".

Paneli vlerëson se nga dispozita e lart cituar, rezulton se të drejtën për ta informuar PZAP, lidhur me rastet e mbajtjes së tubimeve elektorale-publike pa autorizim, gjatë fushatës zgjedhore, e kanë vetëm ZLKZ-ja ose Zyrtaret e Policisë së Kosovës, e që në këtë rast ankesa është paraqitur nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), e cila nuk ka legjitimitet për te paraqitur ankesa të kësaj natyre, andaj si e tillë është hedhur e pa lejuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë, e duke u bazuar në Rregulloren Nr.02/2015 të PZAP-it, nenin 6 paragrafi 4, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.355/2021 më datë 11.02.2021

Kryesuesi i Panelit

Adnan Konushevc



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LPZ-së.